



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

N J O F T I M

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbledhjen e mbajtur me datë 07.04.2016 mori vendim për publikim të njoftimit për lirim nga pagesa e semestrave për studentët e UP-së për vitin akademik 2015/2016, sipas kategorive si në vijim:

- 1. Studentët e tri niveleve të studimeve që janë anëtarë të ngushtë të familjeve të dëshmorëve, të zhdukurve dhe invalidëve të luftës së UÇK-së (ushtarak apo civilë) (neni 6, paragr. 8 Ligji Nr. 04/L-054).**
- 2. Studentët e tri niveleve të studimeve -Veteranët luftëtarë dhe fëmijët e tyre (neni 31 Ligji Nr. 04/L -261).**
- 3. Studentët e tri niveleve të studimeve që kanë mbetur pa njërin prind si pasojë e luftës- Familjar të viktimave civile të luftës 1.1.1998 - 12.6.1999),**
- 4. Studentët me nevoja të veçanta në tri nivelet e studimeve,**
- 5. Studentët e nivelit baçelor dhe master, familjet e të cilëve janë në asistencë sociale,**
- 6. Familjet kosovare që kanë më tepër se një student në Universitetin e Prishtinës, do të paguajnë vetëm për një student, ndërsa për studentë tjerë nuk do të paguajnë (lirohen vetëm studentët në nivelin bachelor dhe master).**

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- 1. Studentët të cilët i takojnë kategorisë 1, 2 dhe 3, duhet t'i paraqesin këto dokumente:**
 - a) Dëshminë që studenti është anëtarë i familjes së ngushtë të dëshmorëve;
 - b) Certifikata mbi njohjen e statusit të veteranit lëshuar nga Komisioni Qeveritar për verifikimin dhe njohjen e statusit të veteranit;
 - c) Vërtetimin e lëshuar nga Komisioni Qeveritar që dëshmon se studenti i takon familjes së ngushtë të zhdukurve dhe invalidëve të luftës së UÇK-së, apo që kanë mbetur pa njërin prind si pasojë e luftës- Familjar të viktimave civile të luftës 1.1.1998 - 12.6.1999;
 - d) Kopjen e vërtetuar të vendimit mbi beneficinet pensionale që i realizon familja e ngushtë të lëshuar nga MPMS (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale);
 - e) Certifikatën e lindjes (nuk ka rëndësi periudha e lëshimit);
 - f) Certifikatën e bashkësisë familjare;
 - g) Kopjen e letërnjoftimit të studentit/es;
 - h) Vërtetimin për statusin e studentit dhe regjistrimit të semestrave të vitit akademik 2015/2016;
 - i) Kërkesën për lirim nga pagesa e semestrit, numrin kontaktues dhe e-mail adresën.
- 2. Studentët të cilët i takojnë kategorisë 4, duhet t'i paraqesin këto dokumente:**
 - a. Kopjen e vërtetuar të vendimit për njohjen e statusit të personit me nevoja të veçanta nga institucioni kompetent, përkatësisht nga shoqatat e licencuara të personave me nevoja të veçanta;
 - b. Certifikatën e lindjes (nuk ka rëndësi periudha e lëshimit);
 - c. Certifikatën e bashkësisë familjare;

- d. Kopjen e letërnjoftimit të studentit/es;
- e. Vërtetimin për statusin e studentit dhe regjistrimit të semestrave të vitit akademik 2015/2016;
- f. Kërkesën për lirim nga pagesa e semestrit, numrin kontaktues dhe e-mail adresën.

3. Studentët të cilët i takojnë kategorisë 5, duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- a. Vendimin për përfitim të asistencës sociale të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- b. Vërtetimin e Qendrës për Punë Sociale për familjen dhe studentin e cila merret në Qendrën për Punë Sociale në Komunë);
- c. Certifikatën e lindjes së studentit/es;
- d. Certifikatën e bashkësisë familjare;
- e. Kopjen e letërnjoftimit të bartësit të ndihmës sociale;
- f. Kopjen e letërnjoftimit të studentit/es;
- g. Vërtetimin për statusin e studentit dhe regjistrimit të regjistrimit të semestrave të vitit akademik 2015/2016;
- h. Kërkesën për lirim nga pagesa e semestrit, numrin kontaktues dhe e-mail adresën.

4. Studentët të cilët i takojnë kategorisë 6, duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- a. Certifikata e lindjes për secilin prej studentëve të familjes së ngushtë;
- b. Certifikatën e bashkësisë familjare;
- c. Kopja e letërnjoftimit të studentit/es;
- d. Vërtetimin për statusin e studentit, dhe dëshminë për regjistrim të vitit akademik 2015/2016, (secili student veç e veç);
- e. Kërkesën për lirim nga pagesa e semestrit në emër të të gjithë studentëve të së njëjtës familje, numrin kontaktues dhe e-mail adresën (kërkesa paraqitet vetëm në njërin prej fakulteteve nga të gjithë studentët që i takojnë kësaj kategorie, ndërsa komisioni vendos se cili prej tyre lirohet nga pagesa) .

Vërtetimi për statusin e studentit, dhe dëshmia për regjistrim të vitit akademik 2015/2016 lëshohet pa pagesë nga njësia përkatëse akademike.

Sqarim: Anëtarë të familjes së ngushtë në kuptim të ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre janë: bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët, fëmijët jashtëmartesor, fëmijët e adoptuar (birësuar), prindërit, njerka, njerku, thjeshtri, thjeshtra si dhe bashkëshorti/bashkëshortja jashtëmartesore.

Afati i paraqitjes së dokumenteve është 8 ditë pune nga dita e publikimit të njoftimit, përkatësisht nga data 12.04.2016 deri me datë 19.04.2016 në ora 15.00.

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet në arkivin e administratës së fakultetit përkatës, ndërsa pas mbylljes së afatit për aplikim, kërkesat dhe dokumentacionin e pranuar, fakultetet e dorëzojnë në rektorat të UP për t'u shqyrtuar nga Komisioni Universitar për lirim nga pagesa. Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim nga komisioni për lirim.

Studentët të cilët lirohen nga pagesa do të informohen përmes fakultetit në të cilin kanë aplikuar dhe ueb-faqes elektronike të UP-së www.uni-pr.edu

Studentët përfitues të së drejtës për lirim nga pagesa duhet të parashtrojnë kërkesë pranë njësisë akademike përkatëse, për rimbursim të mjeteve të paguara për regjistrim të semestrave përkatës të vitit akademik 2015/2016, duke bashkëlidhur dokumentet si në vijim:

-Fletëpagesën e semestrit;

-Kopjen e letërnjoftimit ose ID- kartelës studentore ose indeksit dhe

-Kopjen e kartelës së bankës (nr. i xhirollogarisë të jetë i qartë).

Këshillë juridike: Studentët e pakënaqur me vendim të komisionit për lirim nga pagesa, mund të bëjnë ankesë pranë të njëjtit komision, në ndërtesën e rektoratit në afat prej 48 orësh pas publikimit të vendimit të komisionit për lirim nga pagesa.